

URDHËR
Nr. 47, datë 16.5.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”; si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Procedurat e Prokurimit në Institucionin e Komisionerëve Publikë, kancelarit, znj. Alketa Çeli.
2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, kancelari i Institucionit të Komisionerëve Publikë.
4. Urdhri i Komisionerëve Publikë nr. 10, datë 4.6.2018, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 16.5.2022 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERËT PUBLIKË
Florian Ballhysa, Irena Nino